



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT TE ZHVILLIMIT URBAN DHE SHËRBIMEVE
INFRASTRUKTURE
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

RELACION TEKNIK

OBJEKTI: - “ Ndërtim muri mbrojtës nga përroi Gurra Shushicë dhe ndërtim tombino tërthore ”,
Fshati Shushice, Nj. adm. Shushice, Elbasan

Vendndodhja : Përroi Gurra Shushice ne lagjjen Cerri prane varrezave Shushice , Fshati Shushice
Njesia Administrative Shushice , Elbasan

Qellimi: Ndërtim muri mbrojtës nga përroi Gurra Shushicë dhe ndërtim tombino tërthore ", Fshati
Shushice, Nj. adm. Shushice, Elbasan sherben per mbrojtjen e nenkalimit aktual me tubo Ø 3000 mm
te vendosur mbi Përroin Gurra per kalimin e mjeteve dhe kembesoreve qe perdorin aksin rrugor
(lagjjen Cerri – rruga e varrezave te fshatit Shushice) .

PËRSHKRIMI I SHKURTËR I GJËNDJES

Mbi Perroin Gurra Shushice në lagjjen Cerri prane varrezave fshatit Shushice ne Njësine
Administrative Shushicë në aksin rrugor (Lagjja Cerri – rruga e varrezave te fshatit Shushice) ne
vitin 2023 eshte vendosur nje tombino Ø 3000 mm qe ka sherbyer per kalimin e banoreve dhe mjeteve
mbi perroin Gurra Shushice . Deri ne vitin 2023 kalimi i perroit behej me ure provizore kembesore
per kembesoret dhe ne shtratin e Perroit per mjetet.

Aktualisht kalimi i mjeteve dhe banoreve ne kete perrua eshte bllokuar per arsye te demtimit rruges nga ana
lindore dhe perendimore e tombinos pasi eshte shkaterruar edhe mbrojtja provizore e tombinos ekzistuese.
Dëmtimet paraqiten si në fotot e mëposhtme:



Fig.1 Foto te gjendjes ekzistuese



Fig.2 Foto te gjendjes ekzistuese



QËLLIMI I PROJEKTIT

Ky projekt kryhet për objektin : “ Ndërtim muri mbrojtës nga përroi Gurra Shushicë dhe ndërtim tombino tërthore ”, Fshati Shushice, Nj. adm. Shushice, Elbasan i cili shërben si muri mbrojtës nga përroi Gurra Shushicë për rrugën .

PUNIMET QE DO TE KREYHEN DHE VOLUMET E PUNIMEVE

Punimet kryesore që do të kryhen për objektin : Ndërtim muri mbrojtës nga përroi Gurra Shushicë dhe ndërtim tombino tërthore ”, Fshati Shushice, Nj. adm. Shushice, Elbasan “jane :

- Struktura monolite Betoni C - 12/15 themel + mur prites me lartësi $H = 3.5\text{m}$ dhe gjatësi $L = 30.5\text{m}$.
- Mure mbrojtës me gabjon $1*1*1\text{m}$ $H = 3.5\text{m}$ dhe gjatësi $L = 27.5\text{m}$.
- Ndërtim Tombino me tuba betoni $\varnothing 1500$, mbi shtresë betoni $L = 9\text{m}$
- Mbushja me zhavor e rruges

Volumet e punimeve janë nxjerrë nga planimetria dhe sipas seksioneve tërthore.

Janë bërë llogaritjet e kuotave, të tabanit dhe kuota e projektit me qëllim funksionimin sipas parametrave të projektuar për seksionet.

PREVENTIVI I PUNIMEVE

Preventivi i punimeve, specifikimet për objektin “ Ndërtim muri mbrojtës nga përroi Gurra Shushicë dhe ndërtim tombino tërthore ”, Fshati Shushice, Nj. adm. Shushice, Elbasan , jane bashkëlidhur projekt-zbatimit që shoqëron këtë relacion.

Preventivi i zbatimit është vlerësuar sipas V.K.M. Nr.216 datë 13.04.2023.

Punoi: Ing.Arian Baku



MIRATOI
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE
Ndricim Sinani

